



Prishtinë, 22.03.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1881_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2471_12_23** i datës 07.12.2023;
- Ankesa e parashtruesit e datës 28.12.2023.

në seancën e mbajtur më datë **22.03.2024** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e parashtruesit Ndërmarrja Shërbyese e Transportit Tokësor “Stacioni i Autobusëve Sh.A., Mitrovicë” ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2471_12_23 i datës 07.12.2023.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 07.12.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2471_12_23 me të cilin e ka refuzuar ankesën e parashtruesit, përmes së cilës ishte kontestuar Vendimi i KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë, i datës 08.08.2023 lidhur me kërkesën për rikycje në rrjet dhe kontestim të borxhit.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, ankuesi “Stacioni i Autobusëve Sh.A., Mitrovicë, brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative;
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 22.03.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 28.12.2023; Vendimin e DMK të datës 07.12.2023; Ankesën në KESCO të datës 27.06.2023; Përgjigjen



e KESCO-s të datës 08.08.2023, Ankesën në DMK ZRrE-së të datës 25.08.2023; Procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik të datës 15.11.2022; Faturën e datës 17.11.2011; Procesverbalin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik të datës 17.10.2018; Rrjedhën e energjisë elektrike; Transaksionet; Kontrata nr. 61 e datës 05.05.2022 dhe Kontrata nr. 84 e datës 10.06.2020 dhe Propozimi për përmbaram nr. 5221-20611/2019 e datës 13.12.2019. Njoftimi i KTU “Kosovatrans – Stacioni i Autobusëve” – Mitrovicë i datës 23.12.2019, Vendimi i Drejtorisë së Inspektionit i datës 27.04.2023, Propozimi për Përmbaram i dt. 13.02.2019.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, me datë 15.11.2011, nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut për pranimin e instalimit elektrik, i është bërë pranimi i njehsorit, përmes Procesverbalit me numër 067415, me gjendje të shpenzimeve TL = 004684 kWh dhe TU = 000103 kWh. Me datë 17.10.2018, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, e kanë hequr nga matja njehsorin elektrik me numër 93092996 dhe e kanë vendosur për matje njehsorin me numër 67783892 me gjendje të shpenzimeve TL = 00000 kWh dhe TU = 00000 kWh. Pra, duke u bazuar në këto dy procesverbale, Bordi ka gjetur se është furnizuar me energji elektrike dhe është faturuar që nga periudha 11/2011 e tutje, e cila shifër evidentohet në emër të konsumatorit DPH “ARS” Arsim Ferizi dhe nga Transaksionet e energjisë është vënë re fakti që shpenzimi i energjisë elektrike deri në periudhën 11/2023 është **28,762.74 €**. Ky konstatim i gjendjes faktike nuk është kontestues nga ankuesi.

Në ankesën e tij, ankuesi pretendon që vendimi ka të meta esenciale, sepse DMK e refuzon ankesën e një konsumatori i cili nuk ka legjitimitet aktiv, lidhur me këtë çështje, Bordi i ZRrE-së sqaron se, përderisa shifra DMI – 9040397 akoma figuron në emër të konsumatorit Arsim Ferizi, atëherë DMK i është referuar këtij konsumatori. Përndryshe, në dispozitiv të këtij vendimi është sqaruar se parashtrues i ankesës është Stacioni i Autobusëve Sh.A., në Mitrovicë, përfaqësuar nga Av. Rexhep Podvorica. Andaj, një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm.

Më tutje, nga provat materiale rrjedhë se ankuesi me datë 20.06.2023 ka bërë kërkesë në KESCO që të bëhet ri kyçja e konsumatorit, e ka kontestuar borxhin si dhe ka kërkuar ndërrimin e emrit në shifrën DMI – 9040397, me arsyetimin se borxhi i papaguar është në emër të N.P. “ARS” Arsim Ferizi kurse prona është në emër të “Stacionit të Autobusëve – Mitrovicë”. Pas shqyrtimit të kërkesës, nga KESCO-ja konsumatori ishte njoftuar rreth refuzimit të kësaj kërkesë, me arsyetimin se kërkuesi/ankuesi nuk e ka të drejtën për të parashtruar një kërkesë të tillë, për shkak se mungon raporti juridiko – civil me KESCO-n, dhe se, kalkulimi dhe faturimi është i saktë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor. KESCO-ja tutje e njofton konsumatorin që, kyçja në rrjet për pronën në fjalë do të bëhet vetëm pas kryerjes së obligimeve për shfrytëzimin e energjisë elektrike.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, gjithashtu, ka analizuar edhe Kontratën mbi Qiranë me nr. 84 të datës 10.06.2020 dhe Kontratën me nr. 61 të datës 01.05.2022, dhe ka gjetur se, ndër të tjera detyrime dhe të drejta që janë paraparë në këtë kontratë, në nenin 6, pika e 2, parashihet si vijon: **“Qiramarrësi është i obliguar të vendos orën elektrike dhe orën e ujit dhe t’i regjistroj ato në institucionet përkatëse (KEDS & Ujës-jellës) dhe të kryen pagesën e rregullt për këto shpenzime të cilat i krijon”**. Pra, vendosja e pikës matëse nga vet qiramarrësi, ka qenë një nga obligimet e kësaj kontrate,



si edhe pagesa e rregullt e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe të ujit. Për rastin në fjalë, përkundër që konsumatori nuk kishte paguar energjinë elektrike për vite me radhë, pronari i pronës/ankuesi, përsëri, edhe 2 herë të tjera ia kishte vazhduar kontratën mbi qiranë qiramarrësit Arsim Ferizi, anipse ka qenë në dijeni të shkëljes së këtij obligimi të kontratës, pra, që ta bëj pagesën e rregullt të këtyre shpenzimeve. Siç edhe është cekur në vendimin e kontestuar, në vitin 2020, kur është lidhur kontrata me nr. 84 borxhi ndaj KEK dhe KESCO ka qenë 23,579.66 €, ndërsa, në vitin 2022, kur përsëri i vazhdohet kontrata mbi qiranë, borxhi arrin në shumën prej 28,476.59 €.

Për më tepër, Bordi ka analizuar edhe shkresën /Njoftimin e Stacionit të Autobusëve – Mitrovicë me nr. 216 të datës 23.12.2019 për mos pagesën e faturave të qerasë dhe Vendimin me nr. 354/01 të datës 27.04.2023, dhe ka gjetur se, fillimisht qiramarrësit i ishte bërë me dije për borxhin e akumuluar si pasojë e mos pagesës së qerasë, dhe në rast se nuk i shlyen obligimet e tij karshi pronarit /Stacionit të Autobusëve në Mitrovicë do të konsiderohet si uzurpator i pronës publike dhe se përfundimisht në prill të vitit 2023 i njëjti ishte obliguar që t'i liroj hapësirat (Lokalin) e Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve në Mitrovicë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke vepruar sipas autorizimeve kushtetuese dhe ligjore për mbikëqyrjen e rregullave dhe parimeve që e rregullojnë sektorin e energjisë, thekson se, duke u bazuar në nenin 5, par. 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike – Furnizimi me energji elektrike – *“Të gjithë konsumatorët kanë për obligim që të paguajnë energjinë e shfrytëzuar sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE”*. Më tej, në par. 2 të këtij neni theksohet se *“Furnizuesi duhet të faturojë dhe arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve”*. Po ashtu, duke iu referuar nenin 5, par. 1 dhe 2 të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, theksohet se: *“1. Ndërmarrja e energjisë mund ta shkyçë konsumatorin i cili nuk i përmbahet afatit të pagesës sipas nenit 25 par.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, nenit 14 dhe 15 të kësaj rregulle, apo në kontratën për furnizim. 2. Në rast se konsumatori paraqet prova të qarta të pagesës së faturave ose të këstit ndaj ndërmarrjes së energjisë, sipas marrëveshjes së pagesës, arsye për të cilën është nxjerrë edhe Njoftimi për Shkyçje, atëherë ndërmarrja e energjisë nuk do ta shkyçë këtë konsumator”*. Duke iu referuar dispozitave ligjore si më lartë, Bordi ka gjetur se, të dyja palët, furnizuesi në njërën anë – me mos arkëtimin me kohë të borxhit dhe në vonesat në parashtrimin e mjeteve ligjore për arkëtim të borxhit dhe konsumatori në anën tjetër – me mos pagesën e borxhit të energjisë elektrike të shfrytëzuar, kanë vepruar në kundërshtim me rregullat në fuqi.

Si rrjedhojë, Bordi ka vendosur që, pasi që në shifrën ekzistuese DMI – 9040397 borxhi i akumuluar deri më datë 22.11.2023 është në vlerën prej 28,762.74 €, dhe se kjo shifër është në pronën e ankuesit Stacioni i Autobusëve në Mitrovicë, atëherë, asnjë konsumator, nuk mund të lidhë kontratë të re për furnizim me energji elektrike, pa e përmbushur obligimin financiar që konsumatori e ka ndaj të licencuarit ose Furnizuesit të energjisë elektrike, ose pa ofruar dokumentacion të vërtetuar me të cilin e merr përgjegjësinë ligjore për borxhin e krijuar. Përfundimisht, Bordi qëndron prapa konstatimin të dhënë nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve se, pasi që shifra është në pronë të ankuesit, në këtë shifër ka një borxh ekzistues, dhe se KESCO-ja ka të drejtë që ta detyroj konsumatorin/ankuesin që ta paguaj borxhin e energjisë elektrike, pa rënë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi, pavarësisht faktit se, këtë borxh është dashur ta inkasoj nga konsumatori i cili e ka krijuar. Por që,



duhet ritheksuar faktin se, shifra ekzistuese është në pronë të ankuesit dhe se i njëjti ka qenë në dijeni ose është dashur të ishte në dijeni, që qiramarrësi, nuk është duke i respektuar obligimet e tij sipas kontratës së qirasë. Për më tepër, siç është sqaruar edhe më lartë, përkundër që i njëjti nuk ia shlyer obligimet e tij ligjore karshi ndërmarrjes, pronari (ankuesi) ia kishte vazhduar kontratën e qirasë në vitin 2020 dhe në vitin 2022.

Bordi i ZRRK-së thekson se, edhe duke u bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 përkatësisht në nenin 130 – Krijimi i detyrimeve për kontraktuesit – si vijon: *“Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese”*. Më tej, në nenin 598 – Përdorimi i sendeve sipas kontratës – vijon: *“Qiramarrësi ka për detyrë ta përdorë sendin si ekonomist i mirë, respektivisht si shtëpiak i mirë”*, pronari i objektit si qiradhënësi, e ka ditur ose është dashur ta dinte që qiramarrësi ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore, gjegjësisht nuk e ka respektuar kontratën mbi qiranë. Për më tepër, duke u bazuar në nenin 8 të kësaj kontrate, si vijon: *“Në rast konflikti eventual, palët do ta zgjidhin atë me marrëveshje, në të kundërtën kompetente për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Mitrovicë”*. Rrjedhimisht, pala ankuese, çështjet kontestuese më qiramarrësin, duhet t'i zgjidh në procedurë gjyqësore, ashtu siç edhe parashihet me kontratë.

Duke ju referuar Procedurës për Mbylljen e Llogarisë së Konsumatorit dhe Aktiviteteve të Ndërlidhura, të datës 22.01.2009, duke iu referuar nenit 3 – Ndryshimi i emrit në kontratën për furnizim me energji elektrike – si vijon: *“Ndryshimi i emrit në kontratë, nënkupton edhe ndryshimin e emrit të llogarisë dhe mund të bëhet në rastet: “... kur kontrata me KEK-un është e lidhur në emër të qiramarrësit. Për rastin në fjalë, duhet paraqitur dëftesë pagesën, ku dëshmohet se energjia e shpenzuar është paguar në tërësi”*.

Bordi në të njëjtën kohë ka administruar edhe provën *“Propozim për Përmbarim i datës 13.02.2019”* përmes së cilës vërtetohet fakti se, KESCO ka iniciuar procedurën përmbarimore kundër konsumatorit Arsim Ferizi, përmes përmbaruesit privat Atip Mustafa, për borxhin e papaguar në vlerë prej 9,431.15 €, për periudhën 04.05.2015 – 08.01.2019 dhe se sipas shkresës zyrtare të dërguar, ZRRK njoftohet se procedura përmbarimore është në proces.

Bordi i ZRRK-së ka vënë re që, ankuesi i është referuar një Vendimi të mëhershëm të Bordit, gjegjësisht Vendimit më numër V_1221_2019 të datës 27.12.2019, me pretendimet që rasti është identik dhe se Bordi e kishte aprovuar këtë kërkesë. Lidhur me këtë çështje, Bordi thekson se, rasti në fjalë, dallon përmbajtësish nga rasti i ankuesit, sepse, objekti ka qenë tërësisht i shkatërruar/djegur, biznesi ishte shuar dhe se përkundër që, ishte tentuar të arkëtohet borxhi përmes përmbaruesve privat, konsumatori nuk ishte gjetur dhe lënda kishte mbetur e pazbatuar. Në rastin e ankuesit, është krejtësisht e kundërta, andaj, një referencë e tillë vendimit në fjalë është e gabuar.

Përfundimisht, Bordi ka gjetur se, të tria palët në proces, kanë qenë në shkelje të obligimeve të tyre kontraktuale, ashtu që, pronari i pronës/ankuesi, përkundër që ka qenë ose është dashur të ishte në dijeni për mospërmbushjen e obligimeve të tij financiare karshi ndërmarrjes (e edhe dështimit të përmbushjes së obligimeve financiare të pagesës së qirasë ndaj vet pronarit), përsëri ia kishte vazhduar kontratën e qirasë në vitin 2020 dhe 2022. Në anën tjetër, edhe konsumatori Arsim Ferizi, nuk e kishte paguar energjinë elektrike të shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim të nënshkruar me KESCO-n. Dhe në fund, edhe i licencuari KESCO-ja ka dështuar në përmbushjen e obligimeve të tij, duke e lejuar



akumulimin e borxhit dhe mosndërmarrjen e veprimeve ligjore për inkasimin e tij. Në dritën e këtyre fakteve, dhe më e rëndësishmja, prona në të cilën është krijuar borxhi është në emër të ankuesit – Stacioni i Autobusëve, dhe në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me ndërrim të pronësisë, pavarësisht që shifra është në emër të qiramarrësit Arsim Ferizi, andaj, Bordi, qëndron prapa konstatimit të DMK-së, ashtu që të refuzohet kërkesa e ankuesit, dhe se borxhi si i tillë duhet të shlyhet, në mënyrë që emri i shifrës të ndërrohet ose të hapet një shifër e re.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se parashtruesi i ankesës në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Parashtruesi ankesës: **Stacioni i Autobusëve Sh.A., Mitrovicë** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.